



**KOMUNA E KLINËS**

**KUVENDI I KOMUNËS**

01. Nr. 06-2287/14

KLINË, 28.3.2014

**EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**I SEANCËS SË TRETË TË KUVENDIT TË KOMUNËS, MBAJTUR MË 28.3.2014, NË  
ORËN 14.00, NË SALLËN E KK**

Në seancë morën pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, dr. Haxhi Ibishi, nënkyetari i Komunës, Enver Berisha, anëtarët e Kuvendit (26), drejtoret e drejtorive, Komandanti i Policisë në Klinë, Rexhë Berisha, KFOR-i, OSBE, Zyra ligjore, OJQ-të, mediet etj.  
Seancën e hapi kryesuesi i Kuvendit, Haxhi Ibishi, i cili fillimisht i përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë të KK. “Materialin bashkë me rendin e ditës e keni marrë edhe rendin e ditës, hap diskutimin rrëth rendit të ditës”.

Skënder Merturi, nga Lëvizja “Vetëvendosje”, levoi një deklaratë si përgjigje për Kryetarin e Komunës, lidhur me diskutimin e tij në seancën e kaluar. Kryesuesi vlerësoi dhe konstatoi se deklarata nuk ka të bëjë me rendin e ditës, prandaj nuk është përfshirë në procesverbal.

Deklarata është pjesë integrale në video-incizim.

Haxhi Ibishi, theksoi se deklarata nuk përkon me rendin e ditës. “Konsideroj që secili prej nesh duhet të jetë i përgjegjshëm në deklarimet e veta publike”, shtoi Kryesuesi.

Prend Buzhala, tha se desha edhe prej përvojave jo e gjithë të këndshme të seancave të kaluara, nuk është mirë që një Asamble dhe kreu komunal të krijojë tek qytetarë dhunë ndaj mendimit të lirë, dhunë ndaj bizneseve që nuk guxojnë të shprehin mendimin e lirë, ndaj qytetarëve që nuk guxojnë të shprehin mendimin e lirë. Nuk jemi në kohën e diktaturave të kaluara, këto një herë e përgjithmonë kanë marrë fund, prandaj duhet pasur kujdes. Dhe, pohoi në vijim anëtarë Buzhala, nëse veprohet më kësó sjelljesh siç është vepruar edhe gjatë fushatës zgjedhore dhe tash që po veprohet në asamble dijeni që kemi edhe metoda të tjera për t’ju kundërvë këtyre sjelljeve të ngufatjes së fjalës së lirë. Te rendi i ditës, desha një sqarim: këtu publikisht më është kërkuar që të deklarohem publikisht se cili është statusi im, dëshiroj të jemi drejtor i bibliotekave apo asamblist. Megjithatë, unë isha i përcaktuar këtu dhe kam dëshirë, meqenëse këtu qenka edhe një zyrtar ligjor që ka përvojë në administrata të shumta, atëherë këtu e di që në seancën e fundit ka ardhur nga AAK-ja z. Agron Bacaj për të cilin kam një respekt dhe ka dhënë një betim. Sa di ky zotëri edhe punon, nëse jo le të sqarohen këtu, në shërbime të ngjashme publike. A duhet të përdoren dy kute apo një kut për asamblistët, e para. E dyta, për çështje të arsimit: unë nuk po them që sot të imponohen disa çështje këtu, por meqenëse u zvarritë çështja e komiteteve dhe nuk patëm mundësi që këto t’i prezantojmë përmes GP, unë kisha nja tri çështje: E para, është dhënë edhe konfirmimi solemni i Kryetarit në seancën solemne se në përbërjen e AK-së bëjnë pjesë edhe serbët, për të cilët po ashtu unë shpreh konsideratën time për pranimin e institacioneve, sipas fjalëve të Kryetarit. Pyetja ime është kjo dhe është mirë të sqarohet

opinioni: Arsimi serb, a e pranon sistemin arsimor të Kosovës dhe a është i instaluar në sistemin arsimor të Kosovës, domethënë në sistemin arsimor të Komunës së Klinës. Se e kemi gojën plot integrimë të institucioneve etj., etj.,” shtoi prof. Buzhala, i cili në vijim u shpreh se profesori Hajdin Morina, nuk është këtu, për të cilin kam konsideratë dhe është veprimi më i qëlluar me zgjedhjen e tij në krye të arsimit. “E dyta, vijoi ai, a është shpallur konkursi publik për arsim për vitin shkollor 2013/2014, le të jepen sqarime. Dhe e treta, e di që në fushatë zgjedhore këtu janë hequr fotografitë e Skënderbeut nga Gjimnazi dhe nga Shkolla e Mesme Teknike. Kam informacione se ato nuk janë vendosur ende. A thua mos është politikë e re qeveritare dhe komunale që ato të mos vihen nëpër këto ambiente shkollore për shkak se qenkan në koalicion me një parti të Drejtësisë, e cila urren Skënderbeun dhe identitetin shqiptar. Në fund po jap një konstatim timin, që në seancën e kaluar kam pasur të prezantoj për Bibliotekën Publike. Është shumë e çuditshme se si shpallet një konkurs jashtë çdo lloj kriteri profesional. Është mirë të sqarohet publikisht, se në bazë çfarë kriteresh është shpallur ai konkurs. Biblioteka nuk është zyrë, por institucion publik, prandaj këtu kanë ndodhur ato shkelje”, konstatoi prof. Buzhala. Arben Limani, tha se meqë propozimi i GP të LDK-së nuk hyri në rend të ditës në seancën e kaluar, as tash, domethënë shqetësimet tona që u paraqitën atë ditë nuk kaluan, edhe ky lloj diskriminimi që po bëhet ndaj opozitës është shqetësues edhe për mbarëvajtjen e punës së Asamblesë komunale në Klinë. “Unë shqetësimet që pata atë ditë e që nuk hynë as për këtë seancë, janë dy konkurse të grüpuit tonë, për bibliotekist dhe arkivist në komunën e Klinës, edhe shqetësimi tjeter, i cili vjen nga arsimtarët të cilët kanë qenë kandidatë për Asamblenë komunale. Është një shqetësim me vend pasi të gjithë arsimtarëve u janë ndalë diku 2 paga e gjysmë nga pagat e tyre, duke e ditur edhe gjendjen jo të mirë ekonomike të kësaj kategorie të shtresës së arsimtarëve, domethënë edhe kjo është bërë në kundërshtim me Ligjin edhe me Udhëzimin administrativ të datës 9.10.2013, të lëshuar nga MAPL. Gjithashtu, pohoi në vijim z. Limani, shqetësim tjeter i grüpuit tonë është edhe vizita e fundit e Kryeministratës së Kosovës me arsimtarët dhe personelin e QKMF-së në Klinë, ku me paratë e buxhetit të Komunës sonë paguhet darkë për 550 persona, kur ne e dimë gjendjen e vështirë në të cilën gjenden shkollat tona sot. Tash u informova se nxënës të shkollave tona kanë paguar edhe për mirëmbajtje të shkollave, d.m.th. janë detyruar nxënësit për të paguar një shumë të caktuar për t'i mirëmbajtur shkollat. Këtë vizitë e Kryeministratës së Kosovës me arsimtarët dhe personelin e QKMF-së në Klinë, ku me paratë e buxhetit të Komunës sonë paguhet darkë për 550 persona, kur ne e dimë gjendjen e vështirë në të cilën gjenden shkollat tona sot. Tash u informova se nxënës të shkollave tona kanë paguar edhe për mirëmbajtje të shkollave, d.m.th. janë detyruar nxënësit për të paguar një shumë të caktuar për t'i mirëmbajtur shkollat. Këtë vizitë e Kryeministratës së Kosovës me arsimtarët dhe personelin e QKMF-së, po ashtu edhe me këtë buxhet që e ka komuna jonë, konsiderojmë se shumë më mirë kishte qenë për t'i ndihmuar një shkolle se sa të kthehet një darkë por personelin arsimor, punonjësit të QKMF-së, po ashtu edhe me militantët e partisë”, shtoi anëtari Limani.

Haxhi Ibishi, tha se unë dëgjova deklarime jashtë rendit të ditës se sa propozime konkrete, për të hyrë në rendin e ditës, megjithatë unë respektoj atë qëndrim tuajin.

Qamile Qitaku, tha se kam një propozim që në pikën, Të ndryshme, ne Grupi i grave të AK kemi një njoftim apo një deklaratë.

Halil Desku, pohoi se unë desha të ndalem jo te rendi i ditës, por të merrem me rendin e ditës dhe me parafolësit e mi. “Unë i ftoj të gjithë këta kolegë që të lidhen me rendin e ditës dhe të kenë të drejtë dhe qasje që të shtojnë diçka në rendin e ditës dhe gjithnjë t'i shtrojnë ato çështje që janë pjesë e debatit dhe pjesë kompetencave të veta. Nëse këta shtrojnë çështje që nuk janë në kompetencën tonë, natyrisht se ka për t'u nxitur debat i ashpër. Ky zotëria që një muaj mbrapa i jep përgjigje Kryetarit ka mundur për t'i dhënë përgjigje atë ditë, nuk e ka pasur zor, është dashur që përgjigjen t'ia jap atë ditë, prandaj është dashur për të menduar një muaj për t'i dhënë përgjigjen. Por, nuk kishte pasur nevojë për t'i dhënë përgjigje Kryetarit fare, po që se nuk e kishte parashtuar atë problem atë ditë Kuvendit komunal. Nuk bëhet politika qendrore në

Kuvendin komunal, këtë le ta dinë të gjithë dhe të mësohen për të proceduar me kompetencat e veta. Kjo është ajo, prandaj nuk duhet për të ikur prej rendit të ditës. Edhe atë ditë ka mundur për të hyrë në rendin e ditës po t'i kishte arsyetuar kolegu im Arbeni kishin mundur të përfshihen, kishim mundur për t'i votuar. Por i ka lënë të mjegulluara, nuk është ditur çfarë kërkohet, prandaj edhe nuk ka mundur për t'u përfshirë”, shtoi prof. Desku i cili në vazhdoi: “ Sot u paraqiten disa kërkesa këtu për të hyrë në rend për të cilat mund të diskutohet për to.

Parashtruesit e kërkeseve për rend të ditës jo vetëm që paraqiten kërkesa, por ata debatuan. E rëndësishme është nëse është e arsyeshme për të hyrë në rend ditë le të hyjë, por debati të bëhet më vonë. Unë dua për t'ju përgjigjur me kompetencë të plotë se jam njeri i arsimit dhe jam punëtor në Gjimnaz. U parashtrua një pyetje prej një parafolësi tim për fotografinë e Skënderbeut. Ky vërtet e fyeri institucionin e arsimor, domethënë, sipas tij bashkëpunohet me njerëz të partive të tjera që kanë programe të ndryshme çfarë ai i mendon vetë dhe që i ka thënë. Fotografitë nuk janë hequr, fotografitë e Shkollës Teknike janë marrë me vete, prandaj ato gradualisht kanë për t'u punuar dhe kanë për t'u vendosur aty ku e kanë vendin. Nuk ofendohet në ato baza arsimi, është turp. Prandaj, në rend të ditës këto çështje nuk duhet për të hyrë kurrë, edhe nuk duhet bërë debat për to, sepse, edhe ashtu nuk është kompetencë jona. Nëse duhet për ta paraqitur një shqetësim parashtroje si asamblist, si qytetar me të drejtë të plota ashtu qysh të takon, e jo për të bërë aso fyerjesh. Është trup për t'u marrë me aso vlerësimesh të një niveli shumë të ultë. Nuk janë hequr fotografitë e Skënderbeut, jemi ndarë fizikisht, kur të ndahesh fizikisht dikush merr një bankë, një e lë mangu, e merr një karrige dhe një e lë mangu, e merr një fotografi dhe një e lë mangu etj. Ne jemi në konsolidim, jemi duke i rinovuar shkollat dhe këto gjera mungojnë, por këtu nuk ka asgjë të keqe. Prandaj, duhet pasur kujdes, që njeriu publik të di çfarë po flet. Duhet për të ditur, sepse është para qytetarëve, edhe tri vota po që se i ka marrë le të dëshmojë veten që është duke i përfaqësuar ato tri vota të qytetarëve”, nënvizoi prof. Desku.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se jashtë rendit të ditës dhatë konkludime të gjithë.

**Prend Buzhala**, tha se nuk e kam ndërmend asgjë të polemizoj me Halilin, le të jenë në nderin e tij fjalët që i përdori, se nuk është edukimi im familjar për të përdorur këso fjalësh. “Mirëpo, shtoi ai, e kam unë shqetësimin diku tjetër, domethënë në fushatë ato janë hequr, dhe tash bëhen disa muaj. Kam qenë aktiv gjatë fushatës, por tash që 3 muaj ato qenka vu, nuk po dyshoj në atë, mirëpo e di që asnjë reagim zyrtar nuk ka pasur as prej Qeverisë, as prej të tjerëve me koalicionin që kanë ata kundër fyerjes së figurës së Skënderbeut. Pra, në këtë princip e thashë”, theksoi prof. Buzhala.

**Haxhi Ibishi**, tha se këto janë deklarime që thjesht sqarohen kolegët ndër vete dhe niveli intelektual nuk duhet të keqkuptohet. “Unë mendoj se shqetësimet që i paraqiti Prendi rrëth figurës së Skënderbeut janë shqetësime të opinionistëve të ndryshëm, që sigurisht e kanë atë vlerën e vet. Por një punë e di, në qoftë se ne kemi krijuar në shqiptarët brez mbas brezi e që asaj figure i kemi mbetur gjithmonë besnikë dhe jemi betuar, edhe majtistë, edhe djathtistë, edhe zogistë e parazogistë, NDSH-ist e deri UÇK-ist, për të gjithë ka qenë figura e Skënderbeut e nderuar që na ka unifikuar si tërësi. Mendoj, që thjeshtë, nuk është vendi këtu, ato që i dëgjon profesori, ka të drejtë ato shqetësime që i dëgjon prej njerëzve në Parlamentin e Republikës së Kosovës, për shembull, një deputet aty i paraqet këto qëndrime, nuk i përkojnë Klinës, nuk janë me neve, nuk është qëndrim as nuk është mendim as i dikujt rrëth atyre gjerave që është diçka e shenjtë”, nënvizoi Kryesuesi.

**Agron Bacaj**, tha se e di që çështja për të cilën do të sqaroj është jashtë rendit të ditës, mirëpo kam për obligim të sqaroj rrëth pozicionit tim. “Kam për obligim t'i përgjigjem Prend Buzhalës,

mirëpo edhe ndaj Shërbimit për Punë të Kuvendit. Dy javë nuk kam qenë në Kosovë, kam qenë në një trajtim jashtë vendit dhe kam marrë disa e-maile nga Shërbimi për Punë të Kuvendi. Unë kam dhënë betimin në seancën e kaluar dhe kam njoftuar punëdhënësin tim ku shërbej si shërbyes civil, dhe kam njoftuar se unë kam dhënë betimin në AK të Klinës. Ata e kanë një procedurë, që besoj do të përfundojë shpejt, deri më datën 31 mars, pra para fillimit të muajt, ku ata kanë për ta përgatitur një shkresë konfir Ligjit për Shërbimin Civil, të cilët kërkojnë që unë të përcaktohem në njëren prej pozicioneve, ose këshilltar komunal, ose shërbyes civil. Ligji e thotë decitivisht se shërbyesit civil nuk ka të drejtë për të ushtruar funksion politik. Nëse kjo nuk është implementuar në të kaluarën ky është viti 12 që unë jam rregullisht anëtar i AK dhe viti 14 që jam shërbyes civil. Megjithatë, ka filluar për t'u implementuar dhe këtu nuk shoh asgjë me dy kute dhe pres gjatë këtyre dy ditëve për të ardhur shkresa nga institucioni im dhe unë konform ligjit përcaktohem që cilin pozicion dua ta mbaj”, sqaroi anëtarri Bacaj.

Haxhi Ibishi, tha se për disa çështje që u ngriten, për arsimin, Arbeni, prof. Prendi për çështjen e shpalljes së konkursit, zhvendosjen e fotografisë së Skënderbeut, vizitin e Kryeministrit në Klinë, për arsimin serb, se a pranon apo nuk pranon institucionet legale të Kosovës, ne në KPF kemi debatuar atë ditë dhe përfaqësuesit tuaj kanë dashur dhe kanë pasur të drejtën dhe disponimin për të ngritur edhe çështje të tillë për këtë seancë. Por, meqenëse Raporti i ekzekutivit është në muajin e ardhshëm në të cilin raport përfshihen të gjitha drejtoritë, ne e kemi parë si të udhës për të qenë pikë e shqyrtimit edhe debatit në këto problematika në atë seancë. Por, në qoftë se formuloni grupe të ndryshme parlamentare si kërkesë për të ndryshme sot, futeni si kërkesë të artikuluar, unë do ta hedh në votim dhe ky Kuvend do të deklarohet, a do të futë apo nuk do të futë si pikë të rendit të ditës. Për një sqarim plotësues për shefat e GP, atë ditë kur kemi mbajtur komitetin jemi marrë vesh që me shefat e GP për t'u takuar për dakordimin e rendit të ditës, dhe ra propozimi për t'u bërë po të njëjtën ditë kur është Komiteti për t'u mbajtur edhe takimi i shefave të GP pas një ore ose dy, eventualisht qysh rrjedhin ngjarjet. Teknikisht ka qenë e pamundur që ne për të mbërrí afatin kohor tetëditorë të këtij materiali. Por, i kam ftuar të gjithë shefat e GP dhe jemi dakorduar që edhe kjo seancë që ka më shumë rrëth çështjeve teknike dhe organizimin strukturor të KK, dhe të shkojë kështu, kurse seancat e ardhshme unë e marr zotim publik këtu para jush që menjëherë pas komitetit, nëse komitetin e lëmë për çdo të hënë në ora 10, shefat e GP do t'i thërras në ora 12, të së njëjtës ditë ku do ta përpilojmë bashkërisht”, konstatoi Krye4suesi, i cili në vijim shtoi se po ju them me kompetencë ky Kuvend nuk ka temë të myllur, nuk ka temë që nuk është në gjendje për të hapur debat dhe se shqetësimet që kanë ngritur parafolësit janë shqetësime sigurisht të qytetarëve, se realisht në qoftë se flasim për integrimin ose jointegrimin e një sistemi të përfaqësuesve të komuniteti, sigurisht se duhet për t'u marrë edhe niveli lokal, edhe ai qendor. “Këto janë tema që janë shtruar, prandaj kërkoj me mirëkuptimin tuaj të procedojmë me këtë rend dite, edhe të fusim këtë deklaratën që kanë bërë gratë asambleste si pikë të veçantë të rendit të ditës, e që në seancat e ardhshme do të debatojmë për të gjitha çështjet”, konstatoi kryesuesi Ibishi.

Prend Buzhala, theksoi se unë po pajtoj me atë që ju thatë të shtyhen këto, vetëm se po e shoh një mosgatishmëri për pjesëmarrje në seanca të drejtorëve, sepse janë në funksion të kësaj asambleje.

Haxhi Ibishi, u shpreh se edhe ne e marrim për obligim, një shkresë ia çojmë Kryetarit dhe Nënkyetarit, që në seancat e ardhshme të prezantojnë të gjithë drejtorët në seancat e Kuvendit. Kryesuesi vuri në miratim rendin e ditës me plotësimin në të ndryshme të bisedohet një deklaratë e grave asambleste, edhe ndryshimin e pikës 7, e kemi Shqyrtimi për ndarjen e trojeve dhe e kemi

lënë nëse kompletohet lënda, atëherë le të merret edhe miratim. Atëherë, shtohet shprehja "miratim", apo "vendim" për ndarjen e këtyre trojeve për këto komunitete.

**Me vota 23 vota për 3 kundër u miratua ky**

## **R E N D I D I T Ë S**

- 1. Arsyetimi i mungesave,**
- 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,**
- 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-dhjetor 2013 (Nga Drejtori për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim),**
- 4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Prokurimit për vitin 2014,**
- 5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për shpallje të konkursit publik për anëtarësim në Komite Konsultative dhe themelimi i Panelit intervistues për përgjedhjen e anëtarëve të këtyre komiteteve,**
- 6. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim-vendimit për themelin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) në Komunën e Klinës(Lista me emra nga Kryetari i Komunës),**
- 7. Shqyrtimi i lëndës për ndarje të trojeve të komunitetit RAE si dhe shqyrtimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për dhënie në shfrytëzim të tokës komunale për ndërtimin e shtëpive për strehimin e komunitetit RAE që do të riatdhesohen,**
- 8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Veprimit për komunitetin rom, egjiptas dhe ashkali (referon Zyra e Komuniteteve),**
- 9. Shqyrtimi dhe miratimi i preferencave të KPF-së,**
- 10. Të ndryshme.**

### **Pika e parë: Arsyetimi i Mungesave.**

Kryesuesi sqaroi sa ka arsyetim për anëtaren Shukrije Shala, e cila e ka djalin e sëmurë, mirë shtoi se që nga seanca e radhës do të marr pjesë në seancat e Kuvendit.

### **Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.**

Kryesuesi hapi debatin rreth procesverbalit. Nuk pati vërejtje rreth procesverbalit. Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar. Procesverbal u miratua unanimisht.

### **Pika e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar- dhjetor 2013 (Nga Drejtori për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim).**

Ramiz Rrusta, drejtor i DFEZH, raportoi rreth raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar – dhjetor 2013. "Për këtë kohë nuk kam qenë drejtor i kësaj drejtorie, mirëpo jam i gatshëm të bisedojmë për problemet, të bisedojmë për të hyrat dhe shpenzimet. Të gjithë anëtarët e asamblesë të cilët dëshirojnë të sqarohemi jam i gatshëm t'u përgjigjem", shtoi ndër të tjera drejtori Rrusta.

Avni Gashi, tha se në bazë të raportit që kemi prezantuar në KPF, ku drejtori ka munguar me arsyetim, ne jemi ndalur në emër të Grupit G3 edhe e kemi analizuar këtë raport të shpenzimeve. "Në bazë të këtij reporti të përgatitur nga DFEZH vërehet një rritje e vogël e të hyrave vetanake të Komunës prej 15 për qind. Por, burimet e kësaj rritje janë kryesisht gjobat e trafikut, gjykatat, tatimi në pronë, rreth 20 për qind, edhe participimi i qytetarëve në projekte të ndryshme më me shumë se 65 për qind. Domethënë, rritja prej të hyrave vetanake është participimi i qytetarëve që në mënyrë të tërthortë iu bie dy herë ata për të paguar për secilin projekt që kanë marrë pjesë dhe nuk është diçka për të dëshiruar apo për t'u krenuar për këtë rritje të vogël. Por, ajo që është

shqetësuese, ka zvogëlim të të hyrave në shumicën e kodeve ekonomike, por me shqetësuese është për regjistrim të bizneseve ku vërehet se ka një zbritje më të madhe se 10 mijë euro në krahasim me vitin e kaluar. Ndërsa sa i përket shpenzimeve për vitin 2013 kemi nevojë për sqarime shtesë si është shpenzuar buxheti i Komunës të Klinës. Në bazë të informatave nga drejtoria përkatëse nuk mund të dimë saktësisht se ku janë shpenzuar mjetet e Komunës në raport me planifikimin e shpenzimeve. Kemi vërejtur se ka shpenzime të Komunës përtej planifikimit buxhetor për vlerën 6,464,646,85 euro, e cila është bërë kryesisht gjatë fushatës elektorale me projekte të paplanifikuara, gjë që është shqetësuese këto, kemi shpenzime të Komunës me vendim të gjykatës. Në vend që organet e Komunës të janë shembull për respektim të ligjit, Komuna paguan gjoba me vendim të gjykatës për katër raste në vlerë 39,780.21. Te subvencionet dhe transferet, janë jo të qarta edhe subvencionet në vlerë prej 80,73.92 euro, ku me qëllim apo pa qëllim janë përzier subvencionet për entitete publike dhe persona fizikë, por kemi persona fizikë që kanë përfituar subvencione me shuma 1000, 2000, 2200, edhe këtu figurojnë si subvencione për entitete publike. Përderisa për KF "Dukagjini" dhe festivalin "I këndojmë lirisë" janë dhënë 24900 euro, respektivisht 20 mijë euro për Festivalin. Pajtohem se sporti dhe kultura kana nevojë, mirëpo nuk i kuqtoj subvencionet dhe transferet e dhëna për firma kozmetike, agjensione turistike, minimarkete me vlerë totale 9400 euro. Sa i përket shpenzimeve kapitale, janë të vogla në krahasim me nevojat, por ajo që është shqetësuese te shpenzimet kapitale me theks të veçantë te asfaltimi i rrugëve që shumica e tyre janë bërë gjatë fushatës zgjedhore, pra gjatë muajt shtator dhe tetor dhe siç shprehet populli "shkel e shko", ku shumica e tyre janë prishur menjëherë, si rasti me rrugën e Ujmirit, ku në katër apo pesë vende është dashur të vuhet zhavorr për të mundësuar kalimin e automjeteve. Po ashtu, është bërë një investim prej 40100 eurove në rrjetin e ujësjellësit, ndërsa në anën tjetër Kлина ende mbetet pa ujë të pijshëm. Me gjithë këto investime që janë bërë në këtë fabrikë, po kalon një vit që kjo fabrikë është dashur të lëshohet në përdorim, por për arsyet se veç ekzekutivi i Komunës e di pse nuk është lëshuar. Kemi kërkuar në KPF një raport të detajuar rrëth kontratës së Fabrikës së ujët, mirëpo kemi mbetur pa përgjigje. Banorëve të Klinës po që se bëjmë një kalkulum shpenzimet e ujit për një vit sa është shtyrë funksionimi i Fabrikës së ujët vlera e saj ju kushtojnë 2 milionë euro. E lusim drejtorinë përkatëse të na ofrojë informata më të hollësishme rrëth gjitha këtyre shpenzimeve. Po ashtu, është një zë tjetër shumë i rëndësishëm që janë të paqarta, edhe shpenzimet për kapitale tjera, në vlerë prej 384,156.21 euro, ku janë përfshire të gjitha shpenzimet me një kod ekonomik prej mirëmbajtjes dimërore deri te dekorimi i qytetit, cilat janë ato shpenzime shtesë. Sa i përket mallrave dhe shërbimeve, kemi nevojë për sqarime shtesë lidhur me këto shpenzime. Megjithatë, po i përshkruaj disa: shpenzimet e udhëtimit brenda vendit në vlerë 13,336.20 euro, për çka janë shpenzuar këto mjete? Në qoftë se kanë qenë për bartje të nxënësve, për cilat shkolla është bërë kjo bartje, në qoftë është bërë për Shqipëri është dashur të shkohet në një kod tjetër, jashtë vendit e jo brenda vendit. Sa i përket shpenzimeve për naftë të na sqaroj drejtoria përkatëse sa institucionë përdorin për nxehje këtë lëndë kur dihet se edhe për qymyr dhe dru janë shpenzuar. Ndërsa sa i përket shpenzimeve të veturave, përkatësisht të deriveve që është shumica e shpenzimeve janë mbi 120 mijë euro. Vetëm tri automjete që kanë paguar sigurim më së shumti është automjeti që është paguar 1886 euro. Normalisht kemi edhe automjete të zjarrfikësve që shpenzojnë më shtrenjtë mirëpo do të kishte qenë mirë me e ditur qytetarët e Klinës se cilat janë ato automjete që kaq shtrenjtë iu kushton edhe sigurimi, pa regjistrim dhe shpenzimet tjera. Te drekat zyrtare, që janë 29,707.05, që shihet qartë sa janë jashtëzakonisht të lartë dhe konsideroj se është një luks si komunë që nuk guxojmë për t'ia lejuar vetes, mirëpo ka ndodhur. Më shqetësuese është fakti që në një restoran që emrin e tij e kemi

dëgjuar vetëm në Prishtinë, është edhe në Klinë, por nuk po kemi mundësi për t'i rënë në fije cili është, ka pasur 82 dreka zyrtare në vlerë prej 10245 euro, për çfarë është dashur që zyrtarët e Komunës së Klinës të paguajnë dreka zyrtare në Prishtinë që shprehur në përqindje është afér 40 për qind të vlerës së drekave zyrtare. Bazuar në këtë raport ne kërkojmë s<sub>q</sub>arime shtesë për vitin 2013 para se ta votojmë”, nënvizoi anëtarë Gashi.

Fadil Gashi, tha se kemi diskutuar edhe në KPF, si zakonisht për shumë çështje përgjigje nuk kemi jo vetëm për këtë raport, por edhe për shumë çështje për shumë vite me radhë sidomos për disa kategori. “Kemi kërkuar s<sub>q</sub>arime disa herë rrëth shpenzimeve mirëpo nuk kemi përgjigje. Kësaj radhe kemi një ndryshim që në këtë raport, jo sikur herëve të tjera që na ndaheshin sipas njësive shpenzuese, përkatësisht sipas drejtoreve, ndoshta do të kishim pasur mundësi më mirë për t'i parë në cilat drejtori bëhen shpenzimet, ndërsa tash i kemi të përgjithësuara dhe është problem për t'i ndarë, në cilat drejtori krijohen shpenzime më të mëdha dhe cilat janë pak më të kursyera në këtë drejtim. Po filloj me shpenzimet telefonike: e kemi pasur disa herë debat edhe në të kaluarën, absolutisht unë arsyetoj secilin drejtor të drejtorisë që duhet të ketë shpenzime për telefoninë edhe fikse, edhe të valës, sepse nuk është shumë e madhe po që se nuk ka ndryshuar që ka qenë 30 euro në muaj, nëse llogarisim na del 3 mijë e diçka euro në vit, duke shtuar edhe Zyrën e kryetarit dhe nën kryetarit, por këtu kemi diku 30 mijë euro telefoni fiks dhe Valës 900, dhe nëse ia shtojmë tash këtë pjesën që Kryetari i Komunës i ka pajisur gjithë punëtorët me nga një telefon dhe me ato shpenzime që krijohen vjetore unë kam informacion që shpenzimet vjetore të atyre arrijnë vlerën e 9 mijë euro, domethënë 40 mijë euro Komuna e Klinës duhet për t'i orientuar në telefona. Arsyeshmërinë, unë nuk e kam, është mirë të shikohet edhe të pyete, sa kanë nevojë 2 punëtorë me ata dy telefona që punojnë në të njëjtën zyrë për të komunikuar mes vete, duke pasur parasysh se kanë një telefon fiks në zyrë, duke pasur parasysh që kanë tjetrin telefon enkas për lidhje interne brenda objektit të komunës, brenda gjitha ministritë të Republikës së Kosovës me linjë të veçantë që është pa pagesë, tash t'uua qitësh edhe këtë pjesë këtu është e paarsyeshme karshi asaj që nëse dikush nuk ka marrë ndonjë bakshish për të futur atë kompani ndryshe nuk mund ta kuptoj. Pjesa e dytë, po lidhem te drekat, që edhe këtu po krijohen shpenzime jashtëzakonisht të mëdha, e kemi shumën të gjithë, edhe këtë pa ia shtuar këtë drekën e Kryeministrit që ia la Kryetarit. Po i përgjigjem Halilit: po i shantazhoni edhe profesorët, edhe personelin mjekësor, po i mbani regjistrat kush vjen e kush nuk vjen, e njerëzit kanë nevojë për kafshatën e bukës, kanë nevojë për një vend të punës, por nuk kanë nevojë për t'i shantazhuar. Kjo nuk është mirë bile me këtë gjendje që ka arsimi, që ka shëndetësia, po të shkojmë në Shtëpi të shëndetit, nuk mund ta gjejmë një gjilpërë, atëherë mund të bisedojmë prapë këtu. Po që se gjeni një fashë në Shtëpinë e Shëndetit, atëherë të flasim bashkë këtu. Të gjitha pacienti ka për të dalë për t'i blerë dhe shërbimi ka me qenë vetëm sy më sy. Më së miri e dinë ata që punojnë aty. Gjendja e arsimit, shumë prej nesh i kemi fëmijët tanë aty, edhe unë të mitë. Ju kërkojnë nganjëherë edhe për mirëmbajtje, për t'i fshirë klasat; ju kërkojnë 10 euro kurse, matematikë, fizikë, gjuhë angleze, sepse s'i ia jep 5 pa shkuar në kurs. Ju kërkojnë nga 5 euro javën e kaluar për t'i dërguar te Pusi i Jerinës. Këto këqyrni ju që punoni aty dhe që udhëhiqni, pastaj flasim qysh është gjendja. Te subvencionet: edhe në KPF janë pyetur, kanë bërë përpjekje për të sqaruar, as në të kaluarën, as sot nuk janë të qarta këto subvencione që krijohen. Nëse e shikoni tabelën e fundit sipas kodeve të shpenzimeve komunale, pastaj fillojnë me subvencione “për entitete publike”, ndërsa fill nën të thotë “subvencione dhe transvere”. Muaj nuk po më lidhen njëra me tjetrën. Te pajisjet tjera janë 22 mijë euro, kapital tjetër 384,156.21 euro. Veç këtë me pasur mundësi për të na sqaruar “pajisje tjera” dhe “kapitali tjetër”. Dhe te subvencionet për entitete publike, kishte qenë mirë për të gjithë anëtarët e Kuvendit që me na

sjellë regjistrin e gjithë atyre që kanë përfituar për këtyre subvacioneve, dhe drejtoria ka mundësi për të na sjellë. Do të kishte qenë një pasqyrë më reale dhe më bindëse, që kishim parë cilët janë ata që kanë përfituar prej këtyre subvacioneve. Unë e di që janë disa fusha, bujqësi, blegtori etj., që kanë nevojë për t'u subvencionuar, mirëpo unë nuk kuptoj çfarë kanë nevojë për t'i subvencionuar bizneset. Këtë nuk po mund ta kuptoj. Pastaj s'e kemi atë pjesën që bëjmë kahasime në mes shpenzimeve edhe të hyrave, mungon lista e drejtorive, nuk dimë sa kanë krijuar të hyra drejtore të dhe sa kanë shpenzuar drejtore. E di që në të kaluarën Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, ka qenë ajo më e kursyera, por jo të gjitha drejtore të kanë bërë të njëjtën gjë. Kishte qenë mirë për t'i parë ku ka mundësi për t'u reduktuar këto shpenzime. Konsideroj se ka mundësi për t'u reduktuar, i besoj drejtoret dhe drejtorisë nëse i kontrollon drejtore të tjera. Nëse këta kanë seriozitet për t'i kontrolluar drejtore të tjera ka mundësi për t'u reduktuar shpenzimet për këtë vit që kemi hyrë, ato të kaluara nuk kemi mundësi për t'i kthyer jemi të vetëdijshëm, për këto tash e tutje", konstatoi anëtarë Gashi.

**Halil Desku**, tha se unë nuk dua të ndalem te raporti financiar që është Drejtoria i Ekonomisë që siç shprehet populli, "ju jep copë në dorë". "Meqenëse e nisëm me një debat të shkurtër, mirëpo unë më herët e thashë dhe tash po e them se në momentin që të dalësh prej rendit të ditës keni për të nxitur debate. Sepse, këtu vërehet se janë mbushur plot millef. Prandaj, hynë lajthitjeve, hynë padrejtësish, hynë jashtë rendit të ditës dhe nxitën këto gjera. Nuk lejoj për të prekur arsimin sa të gjendem këtu. Sepse, me mburrje e mbështesin arsimin edhe prindërit që i kanë fëmijët aty. Ka vërejtje kudo nga pak, mrekulli nuk ka askund, mirëpo për ta prekur mësuesin dhe dinjitetin e mësuesit se ka shkuar në një takim me Kryeministrin e vendit, nuk është e mirë. Mësuesit kanë shkuar sepse i ka bërë dinjitoz, edhe çdo kush që del dhe e bën dinjitoz mësuesin e ka me borxh për ta dashur. Mësuesit e duan, harrojeni këto gjera, harroni këto urrejtje. Punët janë duke vajtur mirë, karvani po ecën. Ju flisni!" - shtoi prof. Desku.

**Fadil Gashi**, tha se e para po dua t'i them profesorit se nuk mundet për të mbrojtur gjendjen në arsim, kot e ka. "E di ai qysh e ka gjendjen në arsim, edhe mua më kanë treguar ata që nuk kanë pasur qare pa ardhur, nuk jemi duke folur përmendsh. Nuk flas me emocion, as me ngarkesë, por po flas për një realitet. Mua më vjen keq që është ajo gjendje. Nuk e fyej asnjëherë personalitetin e profesorit. I fyej ata që nuk iu dalin në ndihmë dhe kanë krijuar atë gjendje qysh është. Në të kaluarën ju e dini që ne kemi kërkuar një regjistër të përgatitjeve të profesorëve, ju e dini me çfarë përgatitjesh janë profesorët. E dini se diku 20 vetë janë me juridik. E dini që 4 vjet nuk ka konkurse për pranimin e kuadrove mësimor. Unë kam dëshirë për të dalë gjendja qysh thotë profesori", pohoi Gashi.

**Prend Buzhala**, tha se në emër të grupit që jemi këtu, i presim sqarimet që i ka paraqitur Avniu. "Këtu para vetes po shoh nga tre – katër emra të mëdhenj: financë, ekonomi, zhvillim dhe menaxhim financiar. Domethënë, kur përmendet emrat ekonomi, zhvillim dhe financë, ku ka më mirë se sa për të pasur pare, ekonomi dhe zhvillim, që, pas këtyre shifrave që tha Ramizi del se e gjendjen e kemi parajsë. Zotëri Halili tha: "Është një karvan që po marshon përpara!" Mirëpo, a janë qytetarët ata që e shohin këtë përparim dhe këtë parajsë?!. Unë them se është një diktaturë sociale dhe e mjerimit dhe papunësisë së madhe që është instaluar dhe vendosur këtu dhe nuk mund të thuhet që këto shifra pasqyrojnë një gjendje parajse në Komunën e Klinës, e para. E dyta, unë jam kureshtar të di se sa është investuar në lëmenjtë e kulturës, të sportit e mora vesh, por për të kulturës, ose të bibliotekës, për shembull. Një festival nuk hyn në kuadër të lëmisë së kulturës, sepse Kryetari e ka kompetencë në vete me sa e di unë dhe çfarë është bërë në këtë aspekt. Tjetra, jam kureshtar të di, a përputhet planifikimi me realizim këtu? Te telefonitë, po përmenden shifrat alarmante të shpenzimeve, jam kureshtar të di, sipas ligjit, sa punëtorë duhet

t'i ketë në krye të banorit Komuna dhe sa i ka aktualisht Komuna e Klinës, sa harxhon përtjej asaj norme këtu? Në fund desha këtu te binjakëzimet: unë e di që sistematikisht komuna e Klinës ka bërë binjakëzime me jashtë e brenda, sigurisht këtu ka paguar edhe udhëtimet, cila është kostoja e këtyre binjakëzimeve, rezultati i tyre”, nënvizoi prof. Buzhala.

Rasim Millaku, tha se unë do të ndalem në raportin financiar. “Ky rapport paraqet gjendjen e të hyrave dhe shpenzimeve të një viti që lamë pas. Dua të flas pak shkurtimisht nga pjesa që jam pjesë përbërëse e këtij reporti, si ish-drejtor i Drejtorisë së Inspektoratit. Thjesht, si çështje teknike kërkoj që të hyrat dhe çdo gjë që punohet me shifra shumë më mirë është të ndahet nëpër drejtori. Pavarësisht prej asaj që ka drejtor të mirë, por, ose gjithë drejtorët janë të mirë, edhe këta që janë, edhe ata të kaluar, pse mos të shihet puna e prej neve që kemi qenë, por edhe puna e gjithë këtyre që i kemi përballë. Ne jemi pjesë e pozitës le të themi, mirëpo nuk jemi pjesë e mossuksesit të një drejtori. Nëse ndahen në drejtori sa ka krijuar të hyra edhe ka shpenzuar, pse të mos marr lëvdata sikur që duhet të marr një drejtori. Vetë prezenca e 5 drejtorëve këtu tregon një joseriozitet mosprezenca e 5 drejtorëve të tjerë. E di që kanë angazhime, e di çfarë do të thotë të kesh angazhime, por një ditë në muaj është mirë të prezantohet drejtori nëse kërkohet prej tyre për të qenë këtu. Në pikë të shkurtra le të kuptohet se këtë qeveri do ta mbështesim, nuk jemi ne veç për t'i mbuluar këta me vota, por do t'i kritikojmë për punën nuk e bëjnë. Unë personalisht do të merrem me të gjitha ato kritika për secilin drejtor që se bën, por edhe ai që punon nuk kam për të qenë emocionalisht. Ju ftoj që të punoni të gjithë mirë si drejtorë dhe si qeveri, kur ka rezultate ta themi haptas. Ndani gjitha shpenzimet, të gjitha të hyrat në kategori, pse jo edhe t'i merrni parasysh shqetësimet që i ka opozita. Nuk është turp për t'i prezantuar nëse ka, nëse nuk ka nuk ka”, konstatoi anëtari Millaku.

Agron Bacaj, vlerësoi se pajtohem me ato që i thanë parafolësit, me ato që i tha Avni Gashi, edhe me to që i tha Fadili për gjendjen jo të mirë në Klinë, përkatësisht në arsim. “Mendoj, që Fadil Gashi edhe LDK-ja kanë pjesë të përgjegjësive për këtë gjendje jo të mirë sepse kanë qenë pjesë e pushtetit, ashtu siç AAK-ja e marrim përgjegjësinë për periudhën në të cilën jemi ne në bashkëqeverisje me PDK-në dhe partnerët tjerë. Domethënë nuk është mirë për të mos iku asnjëri përgjegjësive. Është fakt që ne i kemi dhënë vërejtjet sa kemi qenë në opozitë për disa vija buxhetore, për shpenzime. Kemi kërkuar vazhdimisht se shpenzimet në disa vija buxhetore për t'u reduktuar. Mendoj se me një përkushtim më të madh të drejtorëve dhe drejtorive shpenzimet kanë mundësi për t'u reduktuar. Sidomos duhet pasur parasysh shpenzimet e derivateve, mirëmbajtje, drekave zyrtare, telefonike. Këto shpenzime me pak kujdes mund të reduktohen në një masë për të qenë shpenzime sa më racionale. Gjithashtu, tek subvencionet, duhet për të pasur kujdes që këto subvencione për t'u shpenzuar aty ku gjenerohen vende të reja të punës, ku ndikon në përmirësim të jetës së qytetarëve, e jo subvencionet për t'u ndarë në kategori që nuk krijojnë të hyra. Mendoj, që participimi në shëndetësi ka qenë një vërejtje jona e vazhdueshme, edhe drejtori duhet për ta pasur parasysh, edhe krejt institucionit, që participimi në shëndetësi duhet për t'u rritur, sepse kemi një shpërputhje në mes të shpenzimeve që bëhen aty dhe të hyrave që gjenerohen prej QKMF-së. Shqetësimi ynë i vazhdueshëm ka qenë mungesa e ilaqeve dhe materiale të tjera që i mungojnë QKMF-së, në mënyrë që qytetarët këto barnat elementare të mos kenë nevojë të dalin për t'i blerë nëpër barnatore. Mendoj, që me pak kujdes më të shtuar të drejtorëve të drejtorive, disa shpenzime kanë mundësi për t'u reduktuar”, nënvizoi anëtari Bacaj.

Tunë Dedaj, tha se unë kisha pasur, u përmend për dreka, mendoj që aty ku punohet shumë, po ashtu edhe shpenzohet shumë. “Po ashtu, shtoi ai, dëshiroj të ngreh disa çështje për rini dhe

sport, mendoj që është mirë për të rritur shpenzimet për rini dhe sport, sepse vetëm sporti rininë e largon nga disa droga dhe disa të këqija të tjera. Pra, kishte për të qenë mirë që të angazhohemi që rinisë t'i krijojmë kushte sa më të mira për sport dhe kulturë”, shtoi ai.

**Qamile Qitaku**, tha se unë desha të përgjigjëm rreth disa akuzave që u dhanë për shëndetësi. “Meqenëse nuk është drejtori i Shëndetësisë këtu, mirëpo është e vërtetë kemi shumë mungesa sidomos të materialit sanitari, por kjo punë më tepër është në kompetencë të Ministrisë së Shëndetësisë, se sa kompetencë e Komunës së Klinës. Domethënë, edhe ne nuk jemi të kënaqur me këtë gjendje që është, mirëpo kjo është dhe është dhe ne nuk kemi mundësi ta ndryshojmë. Mandej, participimi në shëndetësi: ne e dimë që shumica e kategorive që janë në Kosovë nuk paguajnë, domethënë ka mbetur vetëm të punësuarit, që fatkeqësisht numerikisht është shumë kategori e vogël të cilët participojnë, të tjerët janë të liruar: fëmijët, pleqtë, gratë shtatzëna, pensionistët, veteranët, të sëmurit kronikë etj., pra ka shumë kategori që nuk paguajnë. Me ligjet e MSH domethënë QKMF është goditur, prandaj për këtë arsy qëndron kjo zbritje e participimit. Pastaj një çështje duhet ta kemi të qartë të gjithë, se shëndetësia nuk është organizatë profitabile, edhe ne nuk mund të presim. Sa më shumë që shpenzohet është ajo më domethënësja se ne në mund të rrisim kualitetet dhe numrin e shërbimeve, ne nuk jemi vetë të kënaqur me këtë gjendje që kemi, mirëpo ne edhe në mandatin e kaluar kemi kërkuar që të ndihmohet shëndetësia, meqenëse janë shumë gjera të lidhura, edhe me listën esenciale të barnave që edhe ajo pjesë e MSH. Ne vërtet jemi të vetëdijshëm për shumë probleme, mirëpo ne nuk mund të ndihmojmë asnjëri. Unë kisha propozuar që në njëren nga seancat e ardhshme të bisedohet për shëndetësinë. Nuk na mungojnë kushtet, fatbardhësisht kushtet i kemi shumë të mira, mirëpo shumë herë kemi probleme të ndryshme, si me transportin e pacientëve dhe në aspekte të tjera të shëndetësisë. Atë që e potenco dikush, se punonjësit e shëndetësisë janë shantazhuar me rastin e pjesëmarrjes në darkën kur në Klinë gjendej Kryeministri, çka nuk është e vërtetë. Absolutisht askush nuk është shantazhuar, mirëpo ka ekzistuar vullneti i lirë, kush ka dashur ka marrë pjesë që faktikisht është bërë edhe një ngjarje tradicionale, për çfarë edhe punëtorët ju janë mirënjobës për të gjitha ato të mira që ju bëhen punonjësve shëndetësorë. Kisha dashur vetëm një rast të argumentohet se punëtorët janë shantazhuar, që vërtetë askush nuk ka qenë i shantazhuar”, konstatoi anëtarja Qitaku.

**Haxhi Ibishi**, kërkoi që të mos dilet jashtë kontestit të debatit. “E kemi një raport financiar, prandaj të orientojmë debatin rreth këtij rapporti. Në seancën e ardhshme ku do të jetë Raporti i përgjithshëm i ekzekutivit aty do të keni mundësi të ngrehni edhe çështje të lëmive të ndryshme të problematikave të ndryshme që ju mendoni t'i shqyrtoni”, sqaroi Kryesuesi.

**Filloreta Berisha**, tha se ne nuk jemi të kënaqur me shpenzimet e normës që janë bërë jashtë normave që i përkasin komunës së Klinës. “Unë nuk po dua të lidhem te telefonatat, te shpenzimet e karburanteve, të drekave, darkave dhe të gjitha këto, por dua t’ia jap një përgjigje të shkurtër Agronit. Ai e di që prej 2007 LDK-ja nuk e ka pushtetin, kështu që nuk e ka pasur përgjegjësinë për ta marrë për shëndetësinë. Gjendja në shëndetësi nuk mund të themi se është e mirë kur dihet që nuk është e mirë, kur dihet veç vitin e kaluar janë kryer 360 mijë shërbime, ndërsa janë participuar 24 mijë euro. A, të gjithë veteranët, pensionistët dhe fëmijët po kontrollojkan në QKMF? Nuk është logjike kjo shumë aq e ulët, që domethënë nuk i ka rënë të participojnë as nga 10 centë për shërbime që i kanë kryer. Derisa mungon një shilingë dhe gjilpërë, doktor Haxhiu e dini mirë çfarë do të thotë me ardhur një rast urgjent dhe të mungojnë. Unë nuk mund të jem egoiste dhe të mos pranoj që Kлина nuk ka doktorë të mirë, duke pasur tërë këtë numër të specialistëve, gjithë këta doktorë, edhe me rënë niveli kaq i ulët i shëndetësisë, kjo është gjynah për Komunën e Klinës. Kështu që, kushdo keni mundësi të thoni çfarë të doni,

mirëpo gjendja faktike është kjo që po flitet sot”, vlerësoi dr. Berisha.

**Agron Bacaj**, atë që thotë Filloreta, LDK-ja s’ka qenë pjesë e pushtetit, domethënë njësoj sikur të thuhet AAK-ja aktualisht nuk është pjesë e pushtetit. “Ne aktualisht jemi pjesë e pushtetit dhe duhet t’i marrim përgjegjësitë dhe obligimet që dalin prej këtij pushteti. Po ashtu ne jemi pjesë e sukseseve, por edhe e dështimeve për aq kohë sa jemi në qeverisje me PDK-në. Njëjtë duhet të pranojë edhe LDK-ja për atë kohë sa kanë qenë në bashkëqeverisje. Prandaj, nuk kanë mundësi për t’i ikur as obligimeve, as përgjegjësive pér një periudhë relativisht të gjatë kohore sa kanë qenë pjesë e pushtetit. Tash ne nuk ju ikim përgjegjësive dhe obligimeve pér sa do të jemi pjesë e pushtetit”, theksoi anëtarja Bacaj.

**Qamile Qitaku**, tha se vetëm dua të sqaroj: Është e vërtetë se participimi në shëndetësi është i vogël, por të keni parasysh, një euro kushton vetëm vizita mjekësore, edhe është e vërtetë po ashtu që janë liruar si kategori që nuk paguajnë, edhe në atë 1 euro nuk participojnë ato kategori që i potencova më lart. Ekziston vetëm një kategori që participojnë, janë punëtorët që paguajnë. Të gjithë të tjerët janë të liruar. Ky është një realitet që ndodh te ne. Merreni me mend, nuk është ajo pagesë, por është një participim minimal vetëm pér vizitat mjekësore. Ndërsa, të gjitha shërbimet tjera që bëhen janë pa pagesë. Besoj që parafolësja që flet e di më së miri çfarë do të thotë shërbime të tjera shëndetësore dhe çfarë do të thotë vizita. Janë bërë 170 mijë vizita nuk janë 340 mijë gjatë vitit të kaluar. Së fundmi shifra nuk më rëndësi, me rëndësi pér ta ditur është participim nuk është pagesë”, shtoi anëtarja Qitaku.

**Prend Buzhala**, tha se po i shoh këtu reagimet dhe jam kureshtar të di, meqenëse është pjesë e pushteti lokal AAK-ja dhe ka qenë në opozitë, atëherë sipas kësaj, a do ta aprovojë këtë raport të përgjegjësisë apo të papërgjegjësisë të atyre që kanë qenë në pozitë më parë, pyeti ai.

**Ndue Shabanaj**, tha se unë mendoj se kur shqyrtojmë Raportin financiar pér periudhën njëvjeçare të vitit të kaluar, ata që kanë qenë anëtarë të AK kanë pasur mundësi të jalin kontributin e tyre në çdo 3 mujorë kur janë shqyrtuar këto raporte financiare. “U thanë fjalë që meritojnë të shqyrtohen e të merren në shqyrtim seriozisht dhe mua më tepër më intereson që pér këtë raport nuk dua të jemi të ndarë në pozitë apo opozitë, në kuptimin e akuzave të njërsë palë dhe mbrojtjes së palës tjetër. Mendoj, që raporti financiar është i interesit të përgjithshëm pér gjithë Komunën dhe të jetë angazhimi ynë parimor qoftë pozitë, qoftë opozitë, në kuptimin e asaj se aty ku ka mundësi dhe e shohim një shpenzim i cili ka mundur të kursetet, mund të jetë më i vogël. Natyrisht se duhet të ketë angazhim të përbashkët, që aty ku është e mundur të reduktohen shpenzimet sa është e mundur në të gjitha aspektet sa i përket këtij raporti financiar. Kjo shkon në interesin tonë të përbashkët pa kurrfarë dallimi pozitë-opozitë. Dhe çështje tjetër, unë mendoj, u tha nga parafolësit dhe dëshiroj pér të mbështetur se është mirë ky raport dhe raportet të tjerë që do t’i kemi në vijim të përcaktohen sipas drejtorive. Ekskluzivisht kjo përcakton dhe na jep mundësi ta shohim gjendjen reale në secilën drejtori, ta kemi angazhimin konkret në ndryshim të gjendjes aty kur vërtet varet nga angazhimi edhe i AK, po ashtu edhe i pushtetit lokal përgjithësish”, vlerësoi prof. Shabanaj.

**Fadil Gashi**, tha se desha vetëm një sqarim: Tri vite kam qenë kryesues, ata që kanë qenë në atë mandat e dinë, merreni proceset pér raportin e shpenzimeve i kemi pér vitin 2013, nëse diçka ka ndryshuar, edhe atëherë kur kemi qenë në pushtet, bile ju përkujtoj një rast kur kryetari më është drejtuar “a je me këta apo me ne?” Sepse, gjithmonë i kemi pasur këto vërejtje te shpenzimet, të të hyrat. T’i bëjmë krahasimet, shpenzime ka më të mëdha në disa sektorë, ndërsa të hyra bëhen më pak. Absolutisht një milimetër s’kemi lëvizur sot se nuk jemi në pushtet. Ka qenë vazhdimësi që në disa kategori nuk po ka përmirësimë. Ne bëjmë përpjekje pér të dhënë kontributin tonë, nuk mund të ndryshojmë, sepse kjo është në dorën e pushtetit, e di që nuk mund të ndikojmë”,

shtoi z. Gashi.

**Prend Buzhala**, theksoi se desha vetëm diçka rrith profesorit Ndue, që thotë se është mirë që të shkrihet edhe opozita në pozitë. “Nëse qenka kështu propozimi që të shkrihet opozita në pozitë është mirë, të na paraqet cili është ai projekt, e para. E dyta, vazhdoi ai, unë e di që edhe opozita këtu nuk është sipas dëshirës të atyre që janë ulur këtu në karrige, por është edhe sipas dëshirës së masës së demokracisë. Dhe, ndoshta atyre që janë ulur në karrigen e pushtetit, është mirë të mos ekzistojë fare opozita. Dhe, ja që nuk pytet ai vullnet dhe është dikush tjetër që vendos”, shtoi z. Buzhala.

**Haxhi Ibishi**, tha se ne po bëjmë përpjekje që ta respektojmë opozitën dhe mendimin alternativ të pranohet. “Ato që i thanë edhe Fadili, edhe Ndou, Agroni nuk duhet të merret asgjë tendencioze; ato që i kërkoi sqarimet konkrete Avniu, është drejtori përgjegjës i cili do të sqarojë secilën pare, secilin nivel të parasë kah është shpenzuar. Por nuk duhet të kuptohet se dikush dëshiron të mbrojë këtu keqmenaxhimin, nëse ka. Mendoj, që debati këtu nuk duhet të karakterizohet si pozitë-opozitë rrith numrave shpenzues, rrith parasë publike. Aty ku ka mundësi për t'u përmirësuar pse të mos përmirësohet. Ekziston një temë këtu që u tha që secila drejtori ta sqarojë në mënyrë vetanake të hyrat dhe të dalat, në një farë forme të kemi një pasqyrim rrith atyre, që unë mendoj që është i drejtë. Ju kisha latur edhe një herë që temat që dalin jashtë domenit të shqyrtimit të këtij raporti t'i lëmë për konsumim të ardhshëm, që realisht kemi për të pasur edhe tema të tjera ku do të kemi mundësi për të shfaqur edhe mendimet tonë për shëndetësi, në mënyrë profesionale, edhe për arsim, edhe për shërbime publike, infrastrukturë dhe të gjitha”, shtoi Kryesuesi.

**Ndue Shabanaj**, tha se po marr fjalën sérish se më imponoi zotëri Prend Buzhala. “Nuk është angazhim imi për ta shkrirë opozitën, nuk është angazhim imi i veçantë në raport pozitë-opozitë, angazhimi im është fare parimor. I kam takuar në të kaluarën edhe pozitës edhe opozitës; e kam dëshmuar veten shumë herë dhe gjithmonë e kam ruajtur qëndrimin tim personal dhe kështu do të vazhdoj edhe tani e tutje, jo për hatër Prendit, por për hatër të qëndrimit tim dhe të autoritetit tim, dhe të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes time dhe nuk kam marrë kurrfarë misioni për ta shkrirë opozitën as kurrfarë misioni për asnjë subjekt politik. Kam dëshirë dhe apeloj që të na kursejë në punimet të kësaj asambleje, zotëri, koleg, me ngritje artificiale, të tensioneve të panevojshme në këtë asamble. Unë mendoj se për shumë çështje që ngritën këtu i vlerësoj si tensione të panevojshme dhe që e krijojnë një pasqyrë negative për punimet e asamblesë, e që uroj që Asambleja e Klinës të mos i ketë në vazhdimësi këto. Bëj thirrje këtu hapur që të keni parasysh këtë dhe të drejtën tonë të përfaqësimit, edhe si individ, edhe si përfaqësues të qytetarëve tanë”, konstatai prof. Shabanaj.

**Ramiz Rrusta**, drejtor i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, dha sqarime shtesë rrith interesimeve të anëtarëve të Kuvendit rrith të hyrave dhe të dalave të shpenzimeve të Komunës. “Në Raportin e ardhshëm pasqyrat do t'i keni për secilën drejtori të ekzekutivit veç e veç. Posedoj listën e gjithë atyre që kanë përfituar nga subvencionet, kur vlera e shumës arrin diku rrith 80 mijë euro”, sqaroi ndër të tjera drejtori Rrusta.

Kryesuesi vuri në miratim Raportin financiar për vitin 2013.

**Me 18 vota pro, 8 kundër u miratua Raporti Financiar për vitin 2013.**

**Pika me katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së Prokurimit për vitin 2014.**

**Abaz Foniqi**, zyrtar i lartë i Zyrës së Prokurimit prezantoi Raportin e Punës së Zyrës së prokurimit për vitin 2014. “Ky është vetëm një planifikim teknik i formularëve të përshkruar nga planifikimi dhe miratimi i buxhetit në këtë asamble dhe të dorëzuara në afatet ligjore që parashev

Ligji i prokurimit publik. Edhe në KPF kam thënë që planifikimi i prokurimit duhet të diskutohet dhe të ndërrohen parametrat e saj ta gjejmë një mundësi dhe ta diskutojmë para se të dorëzohet në Autoritetin Qendror të Prokurimit që është që është e domosdoshme dhe ligjore. Në këtë tabelar janë projektet që nuk mund t'i ndryshojmë janë projekte që janë miratuar në këtë AK, teknikisht vetëm janë përshtatur kur mund t'i realizojmë këto projekte edhe pse ajo varet prej intervalin prej momentin kur miratohet buxheti në asamble deri në miratimin e buxhetit në nivel qendror. Ajo na jep mundësi edhe afatet për t'i harmonizuar. Planifikimi të hyjë me miratimin e buxhetit në nivel komunal dhe t'i harmonizojmë. Nuk është fiks ky planifikim, mund ta ndryshojmë sot. Nëse lind ndonjë donacion, ndonjë kërkesë, ndonjë nevojë, edhe ajo mund të prokurohet, nuk ka asgjë të stopuar. Për çdo paqartësi mund të diskutojmë, mund t'i ndërrojmë afatet, vlerat nuk mund t'i rrisim as t'i zvogëlojmë, ato varen tërësisht prej kontratave në vijim”, u shpreh ndër të tjera zyrtari Foniqi.

**Arben Limani**, tha se prej Zyrës së Prokurimit kisha kërkuar një sqarim te këto kontratat përfurnizim, konkretisht përfundatët në furnizim me artikuj ushqimore. “Me këto çmime që shihen këtu janë çmime që janë shumë më të larta që janë në treg”, shtoi ai.

**Skënder Merturi**, tha se te përshkrimi i kontratave kisha dashur një sqarim: nëse ka mundësi të na jepet kur për shembull përujësjellësin e fshatit Zajm iu është kërkuar qytetarëve përkokë banorit nga 5 euro, që do të thotë i bie një shumë 70 mijë euro përujësjellësin në Zajm, a është paraparë dhe çka do të thotë ky participimi i qytetarëve kur qytetarët paguajnë edhe taksa Komunës për shërbimet që i kryejnë dhe shërbime të tjera, por i kërkohet edhe participim. Shumicën e rasteve ju është kërkuar jo vetëm Zajmit, por edhe shumicës së fshatrave të tjera, Grabanicës etj. Atëherë kisha kërkuar një sqarim çfarë kuptimi ka që edhe të participohet edhe të paguhen taksa që i paguajnë gjithë qytetarët”, theksoi z. Merturi.

**Fadil Gashi**, tha se e kemi biseduar edhe në KPF. “Unë e kuptoj që planifikimi, edhe komplet ky dokumentacion që kemi përparrë është obligim ligjor, nuk është përhershëm, e para. E dyta, defekti më i madh ligjor është që ne nuk kemi raport të Auditimit. Ky është skandal më i madh që edhe në të kaluarën gjithmonë kemi kërkuar, ndërsa gjenden arsyetime të llojeve të ndryshme, mirëpo e vetmja Komuna e Klinës në nivel të Republikës së Kosovës që nuk ka shqyrtau prej 2009 asnjë raport të Auditimit, edhe absolutisht nuk i dihen gjetjet, sepse unë e di që Auditori i Jashtëm përcaktoi vitin e bërrë auditim, por nuk i dimë realisht gjetjet që ka bërrë ai auditim. Prandaj, është mungesë e parë që ne nuk kemi këtë raport të Auditimit, qoftë të Auditorit të Brendshëm, qoftë të Jashtëm. Sa i përket planifikimit, vetë fjalë “planifikim” ta jep mundësinë që edhe duhet përtu shqyrtau në fund raporti i këtij planifikimi sa është implementuar. Dhe, aty lidhet që ne nuk e kemi atë reportin e dytë. Edhe e dini mirë që LVL decitivisht thotë se KPF-së t'i sillet Raporti i Auditorit. Kështu e thotë ligji. Pa asnjë ndryshim, pikë as presje. Ne nuk jemi duke respektuar as atë pjesë edhe jemi të hendikepuar përtu shqyrtau heshtjet tjera të prokurimit. Në këtë rast, është risi prej viteve tjera me këtë që kemi marrë kësaj radhe, sepse janë specifikuar edhe gjerat, qofshin ushqimore, qofshin ndërtimore. Në vija të trasha janë disa kategori, edhe në fund janë projektet kapitale. Edhe këtu nëse marrim përtu shikuar miratimin e buxhetit vitin e kaluar përtu 2014, po në të njëjtin buxhet janë planifikuar edhe projekte. Këtu nuk po më del fort në harmoni me atë që kemi planifikuar, në atë buxhet që është miratuar bashkë me ato projekte, që fillimisht kanë ardhur prej ekzekutivit, më pastaj edhe janë plotësuar prej asamblesë, edhe nuk po del që është një harmonizim i atyre projekteve”, shtoi ndër të tjera anëtarë Gashi, i cili, po ashtu edhe në vazhdim u ndal edhe rrëth disa çmimeve që figurojnë në pasqyrën e raportit të gjera e ushqimore, i cili i potencoi disa prej artikujve që figurojnë në rapport, mirëpo sipas tij këto

**Skënder Merturi**, tha se nuk jam kundër për ata që do të kthehen, mirëpo të verifikohen nëse kanë qenë të përfshirë në veprime kriminale. “E dyta, këta persona ku kanë jetuar më parë, pse nuk kthehen në vende të tyre? Unë nuk pajtohem me këtë logjikë. Këtë logjikë nuk e kuptoj. E drejtë është të kthehen, por në vende të tyre ku kanë jetuar më parë. Këta kanë privilegje shumë më të mëdha se sa shqiptarët. Pa asnjë paragjykim jam me Grupin kundër dhënies së tokës komunale”, theksoi anëtari Merturi.

**Enver Gashi**, tha se nuk jam kundër kthimit të tyre, mirëpo të verifikohen biografitë e këtyre personave që pretendojnë për t'u kthyer. “Asambleja e mëparshme e ka pasur marrë një vendim për 7 familje për në Dresnik, mirëpo këta persona nga ai komunitet vendës ishin të papranueshmë. Tash ky numër momentalisht shtohet në 16. T'u verifikojmë biografitë këtyre personave,” tha anëtari Gashi.

**Halil Desku**, tha se Nënkyryetari detajisht i sqaroi çështjet. “Ne kemi proceduar një herë në Kuvend. E kemi anuluar një vendim, kemi gjetur një lokacion tjetër tash duhet marrë një vendim tjetër. Në bazë të dokumenteve të gjitha procedurat ligjore janë të ligjshme. Si shoqëri jemi pajtuar për kthim edhe integrim të komuniteteve pakicë. Rreth çështjes së veprimeve dhe verifikimit të biografive të këtyre personave, me ta do të merren edhe organet e hetuesisë”, shtoi prof. Desku.

**Ndue Shabanaj**, theksoi që të mos debatohet gjatë, të mos përsëriten gjerat. “Janë kërkesat, të shqyrtohen dhe analizohen për secilin vec e vec. Nëse ata kanë qenë qytetarë të komunës sonë organet tona i kanë informacionet për ta, kriteret të plotësohen”, shtoi ndër të tjera prof. Shabanaj.

**Fadil Gashi**, theksoi se është obligim ligjor dhe duhet të votohet. “Këtu kanë të drejtë për të folur të gjithë. Le të jetë hera e fundit, z. Halil, për t'i thënë dikujt ke nevojë me folur apo nuk ke nevojë. Ju vlerësojeni. Është obligim ligjor, është standard. Kërkesat që janë edhe unë jam në dilemë, që tri herë po ndryshojnë kërkesat. Është dashur që kërkesat me qenë të shqyrtuara. E kemi ligjin. Në këtë rast, jemi në gjendje për t'iu shmangur procedurave. Kanë ndryshuar prej asaj të parës. Përbërja e rasteve ka ndryshuar. Jam për t'u respektuar Ligji për gjuhën, ky dokumentacion na ka ardhur në gjuhën serbe, prandaj duhet pasur kujdes që të mos na përsëritet herëve të tjera rasti”, konstatoi ndër të tjera anëtari Gashi.

**Haxhi Ibishi**, tha se të respektohemi mes vete, pa marrë parasysh bindjet politike. “Secili prej nesh të kemi gjuhën racionale të komunikimit”.

**Enver Gashi**, shtoi se në të kaluarën është folur për 7 raste, ndërsa tash na dalin 16. “Pse ky shtim i këtyre rasteve? Nesër do të përballemi edhe me kërkesa të tjera, prandaj çfarë donte bëjmë?”- theksoi anëtari Gashi.

**Halil Desku**, tha se ju siguroj që nuk do tëjeni asnjëherë të rënduar nga ne. “Fola se gjerat i kemi të ditura. Kam folur që seanca të mos rëndohet, për asgjë tjetër”, tha ai.

**Avni Gashi**, tha se në KPF është kërkuar të dihet biografia e gjithë atyre që kthehen. “Sikur të ishin çështjet në rregull, ne nuk do të kishim pasur nevojë për të proceduar rreth kësaj çështjeje”, shtoi ai.

**Rasim Millaku**, foli rreth çështjes tematike. Anëtari Millaku tha se kjo listë ka ardhur nga mosaftësia e Zyrës së Komuniteteve. “E shoh të udhës që ta kryejmë punën, për 16 përfitues të kthyer të merret vendim, po për të përcaktojmë për çfarë kohëzgjatje t'ua japim”, theksoi anëtari Millaku

**Skënder Merturi**, theksoi se propozimi im është që të bëhet verifikimi dhe të kthehen ku kanë qenë. “Nëse kanë jetuar në Zajm, a kanë në Zajm tokë? Le të kthehen atje!- shtoi ndër të tjera ai.

**Qamile Qitaku**, tha se pajtohem me verifikimin e atyre personave që dëshirojnë të kthehen.

“Janë organet e hetuesisë dhe merren me veprimet e tyre. Vonesa kemi, më herët kemi humbur donatorë, prandaj të mos i humbasim donatorët, sa më herët që ta realizojmë këtë projekt, është aq më mirë”, konstatoi anëtarja Qitaku.

**Enver Berisha**, dha sqarime plotësuese rrith çështjes në shqyrtim. “Investimi do të jetë i Malit të Zi. Këto ndërtime që bëhen në pronën e Komunës, pronarët nuk do të kenë mundësi që ato prona t'i shesin. Numri 16 është ekstrakt. Obligimet tona si Komunë i kemi kryer në mënyrën më të mirë. E jona është çështja për t'u zgjedhur karshi arsyeshmërisë. Në Gjeodezi i kemi marrë të dhëna që këta persona nuk kanë prona të tyre”, shtoi nënkyrjetari Berisha, i cili në vijim dha edhe disa sqarime të tjera rrith kësaj çështjeje.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se ne duhet marrë vendim për disa çështje: Çështja e përcaktimit ligor prej sa vitesh dhe për kompensim, apo moskompensim të pronës së shfrytëzuar.

**Fadil Gashi**, tha se te afati ne nuk kemi mandat, t'ia lëmë ligjit. Të marrim vendim për ndarje. Te mënyra e dhënes, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale e përcakton. Duhet për të qenë kompensimi dhe toka nuk tjetërsohet. Zyra ligjore nxjerr vendimin. Nga këtu duhet dalë me një vendim të pakontestueshëm”, konstatoi z. Gashi.

**Ali Shala**, zyrtar i lartë i Zyrës komunale ligjore, në mënyrë juridike i sqaroi çështjet në shqyrtim. “Kemi të bëjmë me një çështje mjaft të ndjeshme dhe të një afatshmërie të gjatë, për çfarë edhe mund të në dalin pasoja të pariparueshme. Kemi ligjin për përcakton çështjen (Zyrtari Shala lexon ligjin që përcakton afatin kohor 15-99 vjet). Në anën tjetër, shton zyrtari Shala, është Rregullorja e Qeverisë së Republikës së Kosovës, prandaj të mos ngutemi, të mos gabojmë. Pika 6 e rregullores (zyrtari Shala lexoi pikën 6 të Rregullores). Të mos vijmë në situatë për të pasur pasoja. Në rastin konkret shfrytëzues është Qeverisa e Kosovës me Ministrinë. Afatin e dhënes e jep Asambleja komunale. Ata njerëz aty nuk kanë tapi. Rregullativa ka lënë edhe hapësira të tjera, që Asambleja komunale ka mundësi për t'i precizuar. Jemi para një sprove mjaft të ndjeshme”, shtoi ndër të tjera zyrtari ligor, z. Shala.

**Fadil Gashi**, tha që të na sqarohet a jemi juridikisht në rregull. “Për mua jemi OK. Është mirë për t'i sqaruar në kontratë dhe me vendim të Kuvendit”, shtoi z. Gashi.

**Prend Buzhala**, theksoi se po dalin disa fakte kontradiktore. “Jemi kundre getoizimeve. Në njëren anë me plot gojën flasim për integrime, ndërsa në anën tjetër bëjmë getoizime të komuniteteve. Në të kaluarën këta persona paskan jetuar në disa vendbanime të kësaj komune, pse atëherë nuk do jetojnë në ato vende?” - theksoi prof. Buzhala.

**Rasim Millaku**, theksoi se punët nuk janë kryer nga akterët. “Nuk janë kryer punët prej akterëve. Leximi i ligjeve paraqet problem. E ritheksoj, se punën nuk kanë kryer aktorët. Kadastri duhet dhënë një rekomandim. Të përgatitet një rekomandim nga Zyra ligjore. Unë nuk dua të jem fajtor për ta shkelur ligjin”, shtoi anëtarri Millaku.

**Ali Shala**, theksoi se kjo çështje është dashur të shqyrtohet më detajisht. “Këtë e ka menduar edhe Qeveria e Kosovës. Nuk di çfarë mund të jap më tepër rrith kësaj çështjeje. Në Rregullore sqarohet, a jepet me kompensim apo pa kompensim. Një mungesë e shoh se nuk jemi mësuar për t'u marrë me letra, por më tepër me amanete. Duhet punuar me letra. Nuk jemi duke folur për 1,2,3 muaj por për 99 vjet”, theksoi zyrtari Shala.

**Haxhi Ibishi**, kërkoi nga zyrtari Shala, që si zyrtar ligor të jap një sugjerim, si të veprohet përditën e sotme. “Dëshiroj për të qenë i qartë: Zyra ligjore të na jap sqarime në mënyrë që të mos i shkelim procedurat ligjore”, shtoi Kryesuesi.

**Ali Shala**, theksoi se me vendim ligor për ta përcaktuar çështjen, afatin etj. “Ju e shihni arsyen te vendimi, apo të shtyni çështjen. Të punohet me letra. Asambleja vendos. Do të kishte qenë mirë për t'u marrë vesh edhe me nivelin qendror. Të qartësohen gjerat. Zyra ligjore dha sqarimet

e veta. Edhe Drejtoria e Urbanizmit do të kishte qenë mirë për t'i dhënë sqarimet”, shtoi zyrtari Shala.

**Tunë Dedaj**, theksoi se investitori është për ta kryer këtë punë, prandaj nuk është mirë që ta detyrojmë investitorin që të largohet. “Një herë kjo asamble e ka votuar. Kisha kërkuar që të votohet”, shtoi anëtarri Dedaj.

**Enver Berisha**, foli rrëth çështjes. Nënkyetari Berisha theksoi se është kompetencë e Asamblesë komunale për ta dhënë pronën e vet. “Edhe Kryetari i Komunës është pro nxjerrjes së këtij Vendimi”.

**Fadil Gashi**, theksoi se është mirë për të qenë një propozim-vendim. “I kemi dhënë tri objekte sociale me banorë dhe që të gjithë japid qira. Mos po bëjmë dallime. Për mua rregullorja është më e vogël se sa ligji. Ligji i ka të definuar çështjet. Të mos bëjmë dallime mes komuniteteve”, theksoi anëtarri Gashi

**Haxhi Ibishi**, tha se ftoj Grupet parlamentare, Nënkyetarin, Zyrën ligjore dhe të Komuniteteve dhe të hartojmë një vendim.

U mor një vendim për një pauzë prej 30 minutave.

Pas pauzës 30-minutëshe u procedua me seancë.

**Haxhi Ibishi**, dha sqarimet rrëth pëlqimit të përgatitur nga shefat e GP, Nënkyetari, Zyra ligjore dhe e Komuniteteve që t'i propozohet Kuvendit për miratim.

Kryesuesi i Kuvendit, z. Ibishi e lexoi pëlqimin e përgatitur nga përfaqësuesit të lartpotencuar.

**Skënder Merturi**, pyeti se a do të ketë prapë kërkesa të natyrës së njëjtë.

Kryesuesi vuri në miratim kërkesën.

**Me 22 vota pro, 2 kundër dhe 1 të përmbajtur u aprovua ky vendim.**

**Pika e tetë: Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për komunitetin RAE (referon Zyra për komunitete).**

**Agim Gashi**, zyrtar i Zyrës për komunitete referoi rrëth Planit të veprimit për komunitetin RAE.

**Fadil Gashi**, pyeti se a ka kosto të financimit. “Është mirë për ta ditur se a ka apo nuk ka kosto financiare”.

**Enver Berisha**, sqaroi Planin e veprimit të komunitetit RAE. “Ka kosto, pjesa më e madhe do të ketë donacione, mirëpo edhe Komuna ka obligime. Kemi kërkuar që kostoja e Komunës të ndryshojë 70 me 30. Ne si Komunë kemi mundësi për ta votuar”, konstatoi ndër të tjera nënkyetari Berisha.

**Prend Buzhala**, tha se e përkrah këtë integrim.

Kryesuesi e vuri në miratim Planin e veprimit të komunitetit RAE.

**Me 25 vota pro, 1 abstenim u miratua Plani i veprimit të komunitetit RAE.**

**Pika e dhjetë: Të ndryshme: Deklarata e Grupit të Grave të Asamblesë komunale të Klinës.**

Në emër të Grupit të Asamblistëve të Kuvendit komunal të Klinës, Deklaratën e lexoi anëtarja e Asamblesë komunale, znj. Qamile Qitaku.

Deklarata kishte të bënte rrëth mospërfshirjes pozitës së gruas, përkatësisht mospërfshirjes së saj në neverisje dhe në pozita të vendimmarrjes në Komunën e Klinës.

**Haxhi Ibishi**, theksoi se është zë i arsyes i asamblistëve. “Edhe Kлина, edhe Kosova kanë për obligim që gruaja ta ketë vendin e merituar në përfaqësim në të gjitha segmentet e jetës”.

Prend Buzhala, theksoi se kjo asamble është në gjendje të marr hapa diskriminues. Një diskriminim pozitiv të ndjehet në të gjitha nivelet nga Komuna e deri në Qeveri”, shtoi ai.

Kryesuesi Ibishi falënderoi anëtarët për kontributin e dhënë. Seancën e konstatai të myllur.

Seanca përfundoi në orën 15.45 minuta.

Procesmbajtësi,  
Mikel Gojani



Kryesuesi i Kuvendit,  
Dr. Haxhi Ibishi